




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. "Media 7 Kosova"
Numri unik identifikues - 811295300
Personi i autorizuar – Kushtrim AJVAZI
Radio 7
Junik



VENDIM

për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, dhe ndryshimin e kategorisë së licencës të Radio 7 – Junik

Fakte

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio 7 është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim lokal, i cili është i licencuar për transmetim të radio programeve në Komunën e Junikut. Më datën 25 mars 2015, Radio 7 është pajisur me licencë transmetimi të KPM-së.
3. Më datën 3 qershor 2020, Radio 7 ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së lokacionit të sistemit të transmetimit nga pika e transmetimit në qytezën e Junikut, për ku janë të licencuar për të transmetuar, për të zhvendosur transmetuesin në pikën e transmetimit në Lagjen Gjocaj.
4. Më datë 4 qershor 2020, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) i KPM-së ka realizuar matjet teknike në pikën e propozuar për vendosjen e transmetuesit të Radio 7 në Lagjen Gjocaj, në koordinatat N °48 28' 58" E 20° 15' 11", për të vlerësuar gjendjen faktike në terren si dhe ka bërë analizën e rezultateve lidhur me ndryshimin e lokacionit të transmetimit, sipas kërkesës së Radio 7.

Arsyetim

5. Neni 16 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 1, thekson se: *Përveç dispozitave për bartjen e pronësisë të specifikuar në Nenin 15, i Licencuari paraprakisht parashtron kërkesë me shkrim për ndryshimet e specifikuara*

në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Rrezatuar Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pasi të jenë miratuar nga ana e KPM-së.

6. Gjithashtu, Neni 16 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 2, thekson se: *“Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor”.*
7. Në bazë të vlerësimit të rezultateve të DMF-së, Komisioni konstaton se, ndryshimi i lokacionit të transmetimit sipas kërkesës së Radio 7, për të zhvendosur sistemin e transmetimit nga pika e transmetimit në qytezën e Junikut, për ku janë të licencuar për të transmetuar sipas licencës, në koordinatat N °48 28' 37" E 20° 16' 35" me lartësi mbidetare 557m, për të kaluar me transmetim në pikën e transmetimit në Lagjen Gjocaj në koordinatat N °48 28' 58" E 20° 15' 11" me lartësi mbidetare 913 m, do të ndikojë në rritjen e zonës së mbulueshmërisë si të territorit dhe numrit të komunave ashtu edhe në rritjen e zonës së mbulueshmërisë të territorit të Republikës së Kosovës nga 6.6% në 12.8%.
8. Komisioni konstaton se, në bazë të këtyre ndryshimeve, bëhet edhe ndryshimi i kategorisë së Radio 7, nga radiostacion me mbulim lokalë në radiostacion me mbulim regional.

Vendim

9. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 30 tetor 2020, merr vendim për miratimin e kërkesës për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit të Radio 7 nga pika e transmetimit në qytezën e Junikut, për ku është e licencuar për të transmetuar sipas licencës, dhe kalimin në pikën e transmetimit në Lagjen Gjocaj, sipas koordinatave të lartëpërmendura si dhe ndryshimin e kategorisë së Radio 7, nga kategoria lokale në kategorinë regjionale.
10. Komisionit vendos që, në rast se shkaktohen interferenca nga lokacioni i ri i transmetimit, ta obligoj Radio 7 që ta kthej transmetuesin në lokacionin e mëparshëm brenda qytezës së Junikut.
11. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Xhevat LATIFI
Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



03.11.2020
datë